

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Karburanti (Gazoil)”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09134100-8
(Karburant Diesel)**

I.1 VLERA E FONDIT LIMIT: 7,397,840 (Shtatë milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dyzetë) leke pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Shkodër ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76”Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe ne mbështetje te Nenit 26”Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me liçencë për tregtim karburantesh të llojit III.1.A ose autorizim për leje tregtimi karburantesh të lëshuar nga njësisia e qeverisjes vendore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për praktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020,2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40 %** e vleres se kontratës përkatësisht **2,959,136 (Dy milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) LEKË**

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 të konfirmuara nga Organet tatimore shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar (vetëm në rastin kur janë objekt i nenshktrimit te auditimit), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” *“Ne lidhje me situaten ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë numrin e operatoreve ekonomikë që ofrojnë këto lloje furnizimesh në tregun shqiptar, sasinë dhe cilësinë e mallit objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë dokumenta se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **2,959,136 (Dy milion e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e gjashtë) LEKË** që është vlera e fondit limit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomikë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 të konfirmuara nga Organet tatimore shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel

te Autorizuar (vetëm në rastin kur janë objekt i nenshktrimit të auditimit), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e fondit limit **1,479,568 (Nje milion e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) leke.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77”Kerkesat per kualifikim”, te Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4..”*ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojten e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervojje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontrata e zbatuara ne te shkuaren” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është midis kufirit të ulët dhe të lartë monetar, vlera për furnizime të ngjashme prej **1,479,568 (Një milion e katërqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) leke** përbën një nivel të mjaftueshëm përvojje duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë fletë/raport analizë të lëshuar nga një laborator i certifikuar në Republikën e Shqipërisë për lëndë djegëse Gazoil 10 ppm ULSD, Benzine (Premium Unl 10ppm) sipas specifikimeve teknike. Fletë/raport analiza duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve të fundit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter është vendosur bazuar në Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel” pasi AK kërkon të garantohet që karakteristikat teknike të mallit të ofertuar të përputhen me standartet teknike të kerkuara nga AK.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) stacion të autorizuar të tregtimit të karburantit me pakicë për automejte në territorin e Bashkisë Kamez. Përbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik duhet ta vërtetojnë nëpërmjet njërës prej formave të disponimit që parashikon Kodit Civil (akt pronësie, kontratë qiraje, etj) duke paraqitur dokumentacionin ligjor vërtetues përkatës.

Shenim: Per kete pike 2.3.3 operoret ekonomik ne fazen e ofertimit duhet te paraqesin formularin e vetedeklarimit sipas shtojces nr.8.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në kete nen, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentim

Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 "Për cilësinë e lëndëve djegëse benzinë dhe diesel", VKM nr. 970, datë 02.12.2015 ""Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar, ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 429, datë 26.6.2019 për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor)", Urdhër Nr. 6, datë. 09.01.2015" Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe Nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifatat përkatëse, Urdhërit nr 315, date 24.08.2017 "Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitetet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimin të naftës dhe nënprodukteve të saj", Ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, "për lejet e Mjedisit", të ndryshuar

Argumentim: Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë.

Ujesjelles Kanalizime Kamez disponojne automjete të tipit Fuoristrada Pick-Up, , fadrome etj të cilët shërbejnë për realizimin e detyrave funksionale te perditshme. Ato e kryejnë aktivitetin e tyre jo vetëm brenda qytetit te Kamzez, por edhe ne Njesite Administrative keshtu që është e

domosdoshme që ato të kenë mundësi të furnizohen me karburant në të paktën 1 pike karburanti brenda qytetit të Kamzes.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se:

Merr përsipër furnizimin gjatë 24 orëve, në stacionet e tij të shitjes së karburanteve me pakicë, me pistoletë publike për çdo mjet të AK, të pajisur me kartë elektronike të personalizuar.

Merr përsipër që kartat elektronike duhet të jenë pa afat skadence dhe të përdorshme edhe gjatë vitit 2025.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika , gërma ç,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Eshte kerkuar qe operatori ekonomik te vetdeklaroje deklarimet e mesiperme pasi AK kerkon garanci qe furnizimi do te realizohet me karta elektronike sipas VKM Nr 561 date 29.07.2016“Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem“, kartat do kene vlefshmeri edhe ne vitin 2023, furnizimi me karburant do behet per ne pistolette publike dhe sherbim 24 ore etj.